



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 32
Prishtinë, më 13 korrik 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302-

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Naim Fetahu, Hajdar Beqa, Abdyl Ymeri dhe Fikrim Damka.

Munguan: Bali Muharremaj, Synavere Rysha dhe Enver Hoti.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit; Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ- i.

Pjesëmarrësit tjerë në takim: nuk ka pasur të pranishëm.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 1.7.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015;
4. Diskutim lidhur me klasifikimin e raporteve të auditimit për vitin 2015, për shqyrtim të mëvonshëm në Komision;
5. Rishikimi i planit vjetor të punës dhe planit financiar të KMFP-së, për vitin 2016;
6. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 1.7.2016

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 1.7.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015

Kryetari njoftoi deputetët se Ministri i Kulturës nuk do të jetë në këtë takim, për shkak se gjendet jashtë vendit dhe propozoi që Raporti i auditimit për MKRS-në, të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së KMFP-së. Për këtë mori aprovimin nga të gjithë deputetët e pranishëm në takim.

4. Diskutim lidhur me klasifikimin e raporteve të auditimit për vitin 2015, për shqyrtim të mëvonshëm në Komision

Kryetari, theksoi se tani, ne si KMFP, kemi pranuar një numër të konsideruar të raporteve të auditimit, që kërkohet prej nesh të kemi një plan sesi do t'i shqyrtojmë, për faktin se edhe koha e shqyrtimit është e shkurtër. Me këtë hapi diskutimin.

Ali Sadriu, theksoi se ne kemi një material të përgatitur nga administrata e KMFP-së, se cilat raporte kanë ardhur në Komision dhe çfarë opinionit kanë. Po ashtu, mendoj se për nivelin komunal, do të zgjedhim një raport me opinion të auditimit të mirë, një me opinion jo të mirë dhe një me mohim të opinionit.

Naim Fetahu, theksoi se është mirë të kemi një plan sesi të bëjmë ndarjen e raporteve deputetë-organizatë buxhetore, sipas renditjes 1-2-3, ku numri mund të jetë 3-4 organizata për secilin deputet.

Abdyl Ymeri, mendoj se ndarja do të bëhet sipas renditjes 1-2-3, me kusht që mos të ketë keqkuptime në selektim të organizatave buxhetore.

Kryetari, theksoi se në mbledhjen e radhës, sekretaria do të përgatisë listën e raporteve, së bashku me deputetët përgjegjës, për të bërë kategorizimin e raporteve të pranura në KMFP, dhe në mbledhjen e radhës, ta kemi ndarjen për secilin deputet. Administrata e KMFP-së, do të takohet dhe do të bëjë këtë kategorizim për mbledhjen e radhës së KMFP-së. Me këtë u mbyll diskutimi për këtë pikë të rendit të ditës, me këtë përfundim.

Përfundim

Administrata e KMFP-së, të përgatitë një raport për mbledhjen e radhës së KMFP-së, duke caktuar nga 3 (tre) raporte të auditimit për secilin deputet të pranishëm në KMFP, sipas renditjes 1-2-3, duke marrë për bazë raportet e auditimit për PVF-të e vitit 2015 dhe opinionet jo të mira, të dala nga këto raporte.

5. Të Ndryshme

Kryetari – Meqenëse gjatë diskutimeve u vërejt se ka interesim për angazhimin e ekspertëve të jashtëm, për të na ndihmuar në analizimin e raporteve të auditimit për Agjencinë e Privatizimit dhe Fondeve të Privatizimit, atëherë mendoj se në mbledhjen e radhës të KMFP-së, ta caktojmë se cili ekspert do të angazhohet për analizim të këtij raporti. Me këtë u mbyll takimi.

Përfundim

KMFP, vendosi të angazhojë 1 (një) ekspert të jashtëm për analizimin e PVF-ve për vitin 2015, për Agjencinë e Privatizimit dhe Fondeve të Privatizimit. Emri i ekspertit të angazhuar do të bëhet e ditur në mbledhjen e radhës së KMFP-së.

Takimi përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli